REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr3998Prot Maliq, më 26.06.2026

VENDIM

Nr 85, datë 25.06.2026

MIRATIMIN E RREGULLORES

"PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TE NGURTA URBANE BASHKIA MALIQ"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak''*gërma "k", neni 55 "*Votimi",* pika 2, neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*" gërma "c" ligji nr. 57/2025 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* ligji nr.10431, datë 09.06.2011 *"Për mbrojtjen e mjedisit"* amenduar me ligjin nr. 53/2020 datë 30.4.2020,Vendim nr. 575, datë 24.6.2015 *"Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte",*Vendim nr.660, datë 31.10.2018 *"Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve",*Vendim nr.608, datë 17.9.2014 *"Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre".* Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e Rregullores "Për miratimin e mbetjeve te ngurta urbane bashkia Maliq", sipas lidhjes bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e shërbimeve Publike në Bashki.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.06.2025

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

RREGULLORJA

PËR

MENAXHIMIN E MBETJEVE TE NGURTA URBANE (MNU)

BASHKIA MALIQ

Grumbullimi i mbetjeve të vëllimshme 18
Shërbimi i pastrimit në tregje 19
Kompostimi i mbetjeve 19
Vendosja dhe karakteristikat e kontenierëve 19
Transporti i mbetjeve 21
Asgjësimi dhe Trajtimi i Mbetjeve 21
Ruajtja higjieno-sanitare për punonjësit e shërbimit 21
KREU V : TARIFAT 22
Objekti i tarifës 22
Llogaritja e tarifës 22
Mbledhja e tarifës 22
Tarifëpaguesit 23
KREU VI :MBAJTJA, PËRDITËSIMI, RAPORTIMI DHE PUBLIKIMI I STATISTIKAVE . 23
Të dhënat e mbetjeve 23
Instrumentet dhe standartet e shërbimit 23
KREU VII : INFORMIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN 24
Detyrimi për informim 24
Procedurat e ankimimit dhe ekzekutimi 24
Manifestimet publike, panairet, spektaklet lëvizëse dhe veprimtari të stinës 25
Fushatat sensibilizuese dhe informuese 25
Bashkëpunimi me organizata jofitimprurëse 26
KREU VIII : NDALIMET, KONTROLLI DHE SAKSIONET 26
Ndalime dhe detyrime 26
Sanksionet 28
Kontrolli 28
KREU IX :DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT 29
Zbatimi i rregullores 29
Hyrja në fuqi 29

— Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
— Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
— Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
— Mbajtja e të dhënave historike për mbetjet;
— Parandalimi i problemeve për shëndetin publik

Neni 3

Baza ligjore

1. Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar me ligjin Nr. 38/2019
2. Ligji nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
3. Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" amenduar me ligjin nr. 53/2020 datë 30.4.2020
4. Vendim Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte"
5. Vendim Nr. 660, datë 31.10.2018 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve"
6. Vendim Nr. 608, datë 17.9.2014 "Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre".
7. VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
8. VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura
9. VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
10. VKM nr.117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje"
11. VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
12. VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
13. VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"
14. VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"
15. VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve"
16. VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
17. VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"
18. VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"

g. "**Mbetje të rrezikshme**" janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme, të listuara në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
h. "**Vajra të përdorura**" janë të gjitha vajrat minerale, lubrifikantë sintetikë apo industrialë që janë bërë të papërshtatshëm për përdorimin, për të cilin ishin prodhuar fillimisht. Vajrat e përdorura përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në vajrat e përdorura të motorëve me djegie të brendshme dhe vajrat e kutisë së ndërrimit të marsheve, vajrat lubrifikuese, vajrat për turbinat, vajrat për transformatorë dhe vajrat hidraulike.
i. "**Mbetje të vëllimshme**" janë mbetje me përmasa të mëdha pajisjesh e makinerish, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave kryhet me metoda e teknika të veçanta; përfshihen objektet e mëdha, të mirat me konsumim të qëndrueshëm si: elektroshtëpiake, pajisjet informatike, mobilje, pjesë autoveturash, metale dhe mbeturina të tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave pengojnë përdorimin e metodave të zakonshme të mbledhjes, transferimit ose hedhjes së tyre;
j. "**Grumbullim**" është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.
k. "**Grumbullim me kontenierë**" është operacioni i largimit të mbetjeve në pika grumbullimi fikse, paraprakisht të përcaktuara nga Bashkia, jashtë vendeve të prodhimit të mbetjeve, ku prodhuesi dorëzon direkt mbetjet;
l. "**Grumbullim i diferencuar**" është grumbullimi, sipas të cilit një rrymë mbetjesh ndahet, në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik.
m. "**Ndarje e mbetjeve në burim**" është ndarja e mbetjeve urbane në fraksione të ndryshme sipas përbërjes merceologjike të tyre për të lejuar rikuperimin dhe/ose ripërdorimin;
n. "**Transportim**" është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.
o. "**Trajtim**" janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.
p. "**Lendfill**" është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë:

(i) një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i lendfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit;
(ii) një vend të përhershëm që përdoret për ruajtjen e përkohshme, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të:
   - impianteve ku mbetjet shkarkohen për t'u përgatitur për t'u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër;
   - vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se tre vjet përpara se të rikuperohen ose të trajtohen;
   - vendet ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre.

q. "**Parandalim**" janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet: a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin

d. përdorimin vetëm të teknikave dhe metodave më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin,ruajtjen, dhe trajtimin e mbetjeve;
e. realizimin e një cikli sa më të shkurtër të menaxhimit të mbetjeve, me qëllim ekspozimin e tyre për një kohë sa më të shkurtër në mjedis;
f. riciklimin, ripërdorimin dhe kompostimin e mbetjeve në një masë sa më madhe;
g. grumbullimin dhe trajtimin e ndarë të mbetjeve në të gjitha fazat e menaxhimit të tyre dhe të mos përzihen me mbetjet e rrezikshme;
h. të mos pengohet përdorimi i mëtejshëm i mbetjeve nga trajtimi i tyre në një fazë të mëparshme;
i. reduktimi në një masë sa më të madhe të lëvizjes dhe transportit të mbetjeve dhe asgjësimi i tyre, të kryhet në impiantin rajonal;
j. parandalimin e ndotjes nga mbetjet dhe kufizimin e ndikimit kur ajo ndodh;
k. ruajtjen sidomos të burimeve natyrore nga ndikimet e mbetjeve;
l. dëmshpërblimin dhe rehabilitimin nga personat fizike ose juridikë të ndotjes dhe dëmtimit që kanë shkaktuar prej keqadministrimit të mbetjeve;
m. mënjanimin e çdo dëmi apo rreziku për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së banorëve;
n. garantimin e kërkesave higjeno-sanitare dhe mënjanimin e çdo rreziku për ndotjen e mjediseve urbane;
o. ruajtjen e florës, faunës, mjedisit dhe peisazheve nga degradimi.

Neni 7

Fazat e sistemit të menaxhimit të mbetjeve

1. Sistemi i menaxhimit të mbetjeve përfshin:
   a. krijimin, ruajtjen dhe ndarjen e tyre nga krijuesi;
   b. dorëzimin sistematik në kontinier;
   c. riciklimin;
   d. kompostimin
   e. dërgimin në venddepozitimin / impiantin rajonal
   f. trajtimin përfundimtar në Impiantin Rajonal.

2. Të gjitha rrymat e mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë rregullore dhe legjisalcionin në fuqi, pas dorëzimit të tyre nga krijuesit janë pronë e bashkisë.

Neni 8

Mbetjet objekt i rregullores

1. Objekt i kësaj rregulloreje janë mbetjet shtëpiake.
2. Në funksion të kësaj rregulloreje, mbetjet shtëpiake i ndajmë në dy kategori:

5. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit ;
6. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese;

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:

a) Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura ;
b) Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve ;
c) Të monitorojnë dhe inspektojë të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve, nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar, në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualet lokale ;
d) Të inspektojnë "zotëruesin e mbetjeve" për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh ;
e) Të bashkëpunojë me ARM-të për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e menaxhimit të mbetjeve ;
f) Të bashkëpunojë me ARM-të si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal

Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

Këshilli Bashkiak: Është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligjit 9537).

Policia e Bashkiake: Është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me Menaxhimin e mbetjeve.

Neni 10
Organizimi shërbimit

1. Bashkia nëpërmjet strukturave të veta apo subjektit të kontraktuar për kryerjen e shërbimit, përcaktojnë dhe publikojnë grafikun e pastrimit të rrugëve, shesheve dhe trotuareve.
2. Pastrimi i rrugëve, shesheve dhe trotuarëve kryhet çdo ditë, përvec rasteve kur lind e nevojshme, përcaktohet që strukturat e bashkisë / subjekti i kontraktuar të kryej më shpesh këtë shërbim.

2. Nëkontratën e shërbimit / statutin apo rregulloren e ndërmarrjes si dhe në termat e referencës, specifikohen të gjitha kushtet dhe kërkesat që ka Bashkia për shërbimin e pastrimit, lagjies / larjes së rrugëve, kontrolli për zbatimin e tyre, si dhe penalitetet.
3. Periodiciteti i shërbimit të pastrimit përcaktohet nga Bashkia në përputhje me nivelin e ndotjes që shkaktohet.
4. Pastrimit i nënshtrohen rrugët e asfaltuara, rrugët me kalldrëm, sheshet si dhe trotuaret e bashkisë të përfshira në kontratë ose në rregulloren e ndërmarrjes. Për lagjien / larjen e rrugëve përdoren automjete të posaçme.
5. Bashkia parashikon të administrojë të gjitha sipërfaqet e gjelbërta publike, të kryejë mirëmbajtjen, ruajtjen dhe pastrimin e territorit nga mbetjet.
6. Përdorimi i uniformave për punëtorët dhe i trajtimit special në përputhje me normat higjeno-sanitare është rigorozisht i detyrueshëm.
7. Mbetjet që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve hidhen në pikat më të afërta të grumbullimit të mbetjeve sipas llojit të mbetjeve që prodhohen.
8. Ndalohet kategorikisht hedhja e mbetjeve që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve në pusetat e elektrikut, në pusetat e telefonisë, në pusetat e ujësjellësit, në pusetat e ujrave të zeza, në pusetat e hidranteve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, në basenet ujore natyrale apo artificiale.

Neni 14

Koshat rrugorë

1. Me qëllimin për të garantuar mbajtjen pastër të hapësiravë publike mund të vendosen dhe të administrohen, nën kujdesin e Bashkisë, kosha rrugor për mbetje të dimensioneve të reduktuara të prodhuara nga kalimtarët.
2. Kalimtarët, mbetjet e çastit si amballazhe të ndryshme, i dorëzojnë vetëm në koshat e vendosur në qytet ose që ndodhen para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.
3. Ndalohet përdorimi i koshave rrugorë për mbetje me vëllim të madh ose për mbetjet shtëpiake.

Neni 15

Pastrimi i pusetave dhe dorëzimi i mbetjeve të pastrimit

1. Zhbllokimi dhe pastrimi i pusetave të rrugëve, bëhet vetëm nga punonjësit e subjektit të ngarkuar me administrimin e tyre.
2. Përpara sezonit të shirave kryhet pastrimi i të gjithë pusetave të ujrave atmosferike, për të siguruar në vazhdimësi trasportimin e tyre. Mbas çdo pastrimi, hiqen menjëherë mbeturinat që dalin nga

5. Çerdhet, kopshtet dhe shkollat, publike e private, mund të përdorin sistemin e disa koshave për të edukuar nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbetjeve.

Neni 18

Dorëzimi i mbetjeve shtëpiake

1. Dorëzimi i mbetjeve është detyrim i prodhuesit dhe bëhet vetëm në vendet publike të mbledhjes së mbetjeve që ka caktuar bashkia ose me kontenierë individualë që përcaktohen sipas llojit të prodhuesit, sasisë së mbetjeve dhe infrastrukturës.
2. Dorëzimi i tyre jashtë rregullave të përcaktuara nga bashkia, është shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.
3. Tregëtarët / persona të tjerë që ushtrojnë shërbime ambulante, duhet të jenë të pajisur me kosh të posaçëm për grumbullimin e mbetjeve që u krijohen gjatë tregëtimit e shërbimit që u ofrojnë qytetarëve.

Neni 19

Përdorimi i kontenierëve publikë

1. Kontenierët publik përdoren nga të gjithë banorët dhe subjektet privatë apo publikë që prodhojnë mbetje shtëpiake.
2. Subjektet privatë apo publikë që prodhojnë më tepër se 1/4 e volumit të një kontenieri duhet të pajisen me kontenier individual brenda territorit të tyre.

Neni 20

Kufizimet për dorëzimin e mbetjeve shtëpiake

1. Dorëzimi i mbetjeve është detyrim i prodhuesit dhe duhet të kryhet sipas mënyrave, ditëve, orareve dhe vendeve të përcakuara nga Bashkia, si dhe të grupuara në përputhje me përcaktimin e bërë në këtë rregullore.
2. Dorëzimi i mbetjeve të tjera që nuk konsiderohen si mbetje shtëpiake do të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga bashkia për këtë qëllim.
3. Dorëzimi i tyre në vendet e mbledhjes së mbetjeve të caktuara në qytet për mbetjet shtëpiake, është e ndaluar dhe ndëshkohet.

Neni 21

Mbetjet Inerte

1. Mbetjet inerte dorëzohen në vend depozitimet e përkohshme apo të përhershme të caktuara nga bashkia për këtë qëllim.

4. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në mënyrë të diferencuar ofrohet nga bashkia në një ose disa mënyra specifike, si:
   a. grumbullimi nëpërmjet kontenierëve publikë;
   b. grumbullimi derë-më-derë(grumbullimi i mbetjeve nga cepi i trotuarit)
   c. grumbullimi nëpërmjet dorëzimit në platforma (sheshe) bashkiake.

5. Prodhuesi i mbetjeve mund të depozitojë mbetjet në mënyrë individuale direkt në pikën e grumbullimit, në përputhje me këtë rregullore.
6. Shërbimi duhet të garantojë grumbullimin e të gjithë mbetjeve që për çfarëdolloj motivi gjenden jashtë kontenierëve, në pikat ku shërbimi kryhet "derë më derë", si edhe grumbullimin e mbetjeve që gjenden të shpërndara në hapësirat publike.

Neni 25

Grumbullimi me kontenierë

1. Grumbullimi nëpërmjet kontenierëve kryhet në hapësirat publike të banimit, bizneseve ose në oborre të subjekteve private / publike dhe në përgjithësi në të gjithë vendet ku është parashikuar një prodhim i konsiderueshëm mbetjesh.
2. Zbrazja e kontenierëve kryhet sipas një grafiku të caktuar në bazë të një kalendari operativ që i komunikohet paraprakisht përdoruesit nën kujdesin e operatorit.
3. Menjëherë pas largimit të mbetjeve territori përreth konteinerëve pastrohet në një sipërfaqe deri në 20-25 m^2. Pas zbrazjes së mbetjeve, kontenierët dezinfektohet me lëndë dezinfektuese që miratohen nga Ministria e Shëndetësisë apo institucione në varësi të saj.
4. Nuk do të lejohen në asnjë rast kontenierë të tejmbushur me mbetje, të patransportuara dhe mbetje të lëna në zonën përreth kontenierëve ose në vendet e përcaktuara.
5. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre.
6. Përdoruesi është i detyruar të përdorë kontenierin e disponueshëm, më të afërt dhe të mbyllë kapakun nëse kontenieri ka një të tillë. Në rastet kur kontenieri është i tejmbushur nga qeset, mbetjet duhet të dorëzohen në kontenierin tjetër disponibël dhe nuk duhet të lihen asnjëherë në tokë.
7. Kontenierët lahen dhe dezifektohen sipas një grafiku të miratuar nga bashkia me lëndë dezifektuese, desinsektante dhe deratizuese.

Neni 29

Shërbimi i pastrimit në tregje

1. Tregtarët / grup personash tregtarë që zënë vendet e shitjes në tregjet privatë apo publikë, të organizuar në hapësirat publike ose private, kryejnë vetë pastrimin e territorit të tregut menjëherë pas mbylljes së aktivitetit ditor. Administratorët e tregjeve ose personi i autorizuar nga bashkia monitoron proçesin e administrimit të mbetjeve. Për sa i përket administrimit të mbetjeve që dalin, këto tregje duhet të operohet si më poshtë vijon:
    a. Administratori i tregut privat / përfaqësuesi i tregtarëve / personi i autorizuar nga bashkia monitoron pastrimin e territorit të tregut dhe largimin e mbetjeve për në vendin e caktuar nga bashkia. Subjektet mund të lidhin kontrata të veçanta me bashkinë ose operatorët privatë, që të garantojnë zbatimin e kushteve higjeno-sanitare të kësaj rregulloreje;
    b. Në rastet e tregjeve publike që administrohen nga bashkia, ky shërbim përfshihet në shërbimet e tjera të pastrimit që administron bashkia;
    c. Detyrimisht çdo treg duhet të ketë të miratuar nga bashkia vendet e grumbullimit të përkohshëm ose të përhershëm, brenda territorit të tregut, për të mundësuar vendosjen e kontenierëve.
2. Të gjithë shitësit e tregut të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mbetjet që krijojnë gjatë tregtimit të produkteve vetjake, i grumbullojnë dhe i hedhin në pikat e përcaktuara nga bashkia. Largimi nga tregu pa bërë këtë sistemim të mbetjeve është shkelje që ndëshkohet me moslejimin për të tregëtuar përsëri në treg.

Neni 30

Kompostimi i mbetjeve

1. Kompostimi i mbetjeve bio kryhet në oborret e shtëpive, apo në vende të posaçme për grupe familjesh, të përcaktuara nga bashkia në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Për zonat rurale do të kryhet kompostimi në oborret e shtëpive ose në vende të caktuara për një grup familjesh. Vendet e kompostimit për grupe familjesh përcaktohen në bashkëpunim me strukturat e bashkisë duke përmbushur kriteret higjeno-sanitare.
3. Është i ndaluar pranimi dhe përpunimi i rrymave të mbetjeve të tjera apo të rrezikshme në strukturën e kompostimit.

Neni 31

Vendosja dhe karakteristikat e kontenierëve

1. Kontenierët parashikohen në numër të tillë që të sigurojnë grumbullimin në kohë dhe në sasi midis flukseve të çdo cikli dorëzimi.

Neni 32

Transporti i mbetjeve

1. Transporti i mbetjeve për në venddepozitim/ impiantin rajonal apo vendet e trajtimit bëhet nga bashkia ose nga një palë e kontraktuar prej saj.
2. Transporti organizohet dhe funksionon në orët e mbrëmjes apo gjatë ditës në orare të përshtatshme.
3. Transportimi i mbetjeve nga pikat e grumbullimit për tek venddepozitimi / impianti rajonal apo në vendet e trajtimit të tyre, bëhet me mjete teknologjike të posaçme dhe të mbuluara, ngarkesa e të cilëve nuk rrezikon derdhjen apo rishpërndarjen e mbetjeve.
4. Kamionët që transportojnë lëndë dhe materiale ndërtimi ose që çojnë mbetjet inerte në vendet e trajtimit apo depozitimit të tyre, marrin masa që gjatë lëvizjes të mos ketë derdhje apo rrjedhje të materialeve që transportojnë.
5. Kamionët, autoveturat, etj, kur hyjnë në rrugët e bashkisë nga kantierët e ndërtimit dhe nga rrugë dytësore të paasfaltuara, janë të detyruar të pastrojnë gomat nga balta, llaçi, betoni e çdo papastërti tjetër që ndot hapësirat e bashkisë.

Neni 33

Asgjësimi dhe Trajtimi i Mbetjeve

Asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve do të kryhet në venddepozitimin / impiantin rajonal.

Neni 34

Ruajtja higjieno-sanitare për punonjësit e shërbimit

1. Mbrojtja higjieno-sanitare e punonjësve të shërbimit të administrimit të mbetjeve bëhet në përputhje me normat për sigurinë dhe higjienën e punës të parashikuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

2. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me veshje të përshtatshme dhe me mekanizma apo pajisje për mbrojtje personale dhe duhet t'i nënshtrohen trajtimeve për kontrolle sanitare të parashikuara në ligj.

Neni 38
Tarifëpaguesit

1. Niveli i tarifës përcaktohet me vendim të Këshillit Bashkiak.
2. Vendosja e tarifës së pastrimit, pagesa dhe marrja e saj kryhen sipas vendimit të Këshillit Bashkiak për tarifën e pastrimit.
3. Bashkia mund të aplikojë tarifa të ndryshme sipas gjendjes ekonomike të familjeve dhe llojeve të ndryshme të prodhuesve, duke u bazuar në shërbimin që përfitojnë, sasinë dhe llojin e mbetjeve që gjenerojnë.
4. Mund të aplikohen gjithashtu pagesa shtesë mbi tarifat për biznese të veçantë, në rastet ku lloji dhe sasia e mbetjeve që prodhojnë nuk mund të përballohet nga shërbimi publik i grumbullimit të mbetjeve. Për këto biznese mund të aplikohen zbritje të tarifës, nëse marrin vetë përsipër largimin e mbetjeve. Në këtë rast mund të aplikohet vetëm tarifa për trajtimin e mbetjeve në impiantet e trajtimit të tyre.
5. Për çdo ndryshim të masës së tarifave shpallet një vendim ndryshimi. Afati i tarifës së re përcaktohet në vendimin e ndryshimit. Mbipagesat trashëgohen.

KREU VI :MBAJTJA, PËRDITËSIMI, RAPORTIMI DHE PUBLIKIMI I STATISTIKAVE

Neni 39
Të dhënat e mbetjeve

1. Bashkia duhet të plotësojë formatin e raportimit të statistikave vjetore për mbetjet e krijuara në territorin e saj, sipas përcaktimeve ligjore dhe këto të dhëna t'ia dërgojë Këshillit të Qarkut, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrisë përgjegjëse.
2. Bashkia zbaton metodologjinë për grumbullimin, gjenerimin dhe përpunimin e tëdhënave për menaxhimin e mbetjeve, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 40
Instrumentet dhe standartet e shërbimit

1. Bashkia siguron dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:
    - njësive organizative të veta që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore; ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;

4. Pala që kryen shërbimin shqyrton ankesën dhe brenda 24 orësh merr masa për zgjidhjen e saj. Pala ka detyrimin të informojë drejtorinë përkatëse për zgjidhjen e ankesës brenda tre (3) ditësh, në varësi të problematikës.
5. Bashkia ka të drejtën të dërgojë një përfaqësues për të kontrolluar zgjidhjen e ankesës. Në qoftë se përfaqësuesi vëren mangësi, ai duhet të njoftojë palën që kryen shërbimin për këto mangësi. Pala duhet të njoftojë kur këto mangësi janë plotësuar. Pala duhet të rikontrollojë punën për të parë nëse gjithçka është plotësuar.

Neni 43

Manifestimet publike, panairet, spektaklet lëvizëse dhe veprimtari të stinës

1. Çdo grupim qytetarësh që ka për qëllim organizimin e iniciativave si festa, panaire, festime popullore, vrapime, spektakle lëvizëse ose manifestime të llojit kulturor apo sportiv, etj, në rrugë, sheshe dhe hapësira publike apo për përdorim publik, janë të detyruar të sigurojnë direkt, ose nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta me Bashkinë, mbajtjen pastër të hapësirave që u janë dhënë atyre për përdorim, si gjatë ashtu edhe në fund të iniciativës. Subjektet duhet të dorëzojnë në kontenierët e përshtatshëm të vendosur nga administratori, mbetjet e prodhuara nga aktiviteti i tyre si dhe ato të prodhuara nga frekuentimi i manifestimit prej qytetarëve.
2. Detyrimet suplementare të dala nga kryerja e shërbimit publik do t'i ngarkohen organizuesve të manifestimeve gjatë procesit të dhënies së lejes për organizimin.

Neni 44

Fushatat sensibilizuese dhe informuese

1. Bashkia kujdeset për organizimin e fushatave të nevojshme për edukimin, sensibilizimin dhe nxitjen e bashkëpunimit me komunitetin në proçesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
2. Në mënyrë periodike kryhet një reklamim në masë të gjerë nga bashkia ose nga subjekti i kontraktuar, nëpërmjet materialeve gjithëpërfshirëse, i rezultateve cilësore dhe sasiore të arritura gjatë viteve paraardhës, në veçanti për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve, me qëllim pjesëmarrjen aktive të komunitetit.
3. Në mënyrë periodike shpërndahet falas një broshurë me orientime, udhëzues për dorëzimin e duhur të materialeve të ndryshme, për përdorimin e kontenierëve dhe vendndodhjen e tyre; ndër të tjera do të jepen edhe orientime mbi fraksionet që grumbullohen, mënyrat e dorëzimit dhe destinacionet e tyre, duke shpjeguar arsyet dhe nevojat e bashkëpunimit me qytetarët.
4. Duhet të promovohen, nga drejtoritë përkatëse në bashki, sipas rastit në bashkëpunim me personat juridikë të përfshirë, fushata edukimi dhe informimi drejtuar qytetarëve me synim specifikimin:
    a. e llojeve të mbetjeve për të cilat është aktivizuar shërbimi i diferencuar;
    b. e qëllimit dhe mënyrave të kryerjes së shërbimeve;
    c. e destinacionit të fraksioneve që rikuperohen;

2. Përveç ndalimeve të shpehura qartë në nenet e Rregullores:
   a. Është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në të gjithë territorin bashkiak, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, i çdo lloj mbetjeje, papastërtie, hedhurine të ngurtë, gjysëm të ngurtë, të lëngët dhe në përgjithësi materiale mbetjesh dhe hedhurinash të çdo lloji, natyre dhe dimensioni, edhe pse të mbyllura me qese. Ky ndalim është në fuqi për sipërfaqet ujore, lumenjtë, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet, anët e rrugëve, etj.
   b. Është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve në vendet e zbuluara të hapësirave private, në trojet e sheshet, të rrethuara ose jo, në të cilat nuk ka filluar ndonjë veprimtari ndërtimore apo e çdo natyre tjetër. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbetjeve.
   c. Cilido shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryejë largimin e mbetjeve. Ky veprim duhet të kryhet nga pronari apo personi me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i Bashkisë cakton nëpërmjet një urdhërese operacionet e nevojshme dhe afatet brenda të cilave duhet të veprohet.
   d. Është e ndaluar për qytetarët dhe për cilindo person të paautorizuar, të kryejë çdo lloj selektimi manual të mbetjeve të dorëzuara brenda kontenierëve, gërmimin apo marrjen e mbetjeve të dorëzuara në kontenierë, ose pranë impianteve të rikuperimit dhe përpunimit final.
   e. Në rastet e shërbimit të grumbullimit "derë më derë" është i ndaluar ekspozimi i qeseve dhe/ose kontenierëve shtëpiakë që kanë mbetje, përgjatë rrugës, në ditë të ndryshme dhe jashtë orareve të përcaktuara nga Bashkia.
   f. Është e ndaluar hedhja në kontenierë apo në pajisjet e përdorura për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve të ngurta, e mbetjeve të lëngëta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mirë, e substancave të ngrohta apo ndezëse, dhe e mbetjeve të forta që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik.
   g. Është e ndaluar hedhja e mbetjeve të ndryshme nga ato për të cilat janë vendosur kontenierët ose është caktuar shërbimi i grumbullimit.
   h. Është i ndaluar dorëzimi i mbetjeve voluminoze që nuk janë reduktuar më parë, si për nga dimensioni, përbërja dhe karakteristika të tjera që mund t'i shkaktojnë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit, për më tepër mund të shkaktojnë rreziqe për qytetarët apo personat përgjegjës për shërbimin.
   i. Është e detyrueshme për të gjithë llojet e prodhuesve dhe mbajtësve të mbetjeve shtëpiake, objekt i grumbullimit të ndarë me qëllim rikuperimin e materialeve dhe energjisë, t'i dorëzojnë këto materiale në përputhje me mënyrat e caktuara në shërbimet respektive.
   j. Është i ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, pajisjeve të përdorura për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, dëmtimi apo përmbysja e tyre.
   k. Janë të ndaluara sjelljet që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve apo hapësirat ku kryhet shërbimi i fshirjes.

KREU IX :DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 49
Zbatimi i rregullores

1. Zbatimit të kësaj rregulloreje i nënshtrohen:

   a. organet shtetërore dhe organizatat vendore;
   b. të gjithë individët, banorë të qytetit e të zonës, kalimtarë të rastësishëm, turistë e pushues, shtetas të huaj rezidentë në bashki, punonjës në organe e organizma publike e privatë;
   c. të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregtare, shoqërore, arsimore, kulturore, artistike, shëndetësore, turistike etj;
   d. personat juridikë e fizikë, publikë dhe privatë, vendas apo të huaj, të angazhuar me kontratë dhe të liçensuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

Neni 50
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn nëfuqi sipas përcaktimeve tëpikës 6, tënenit 55, tëligjit nr. 139/2015, "Për vetë qeverisjen vendore", të ndryshuar.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ